

A ekziston Perëndia në të vërtetë?

«Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën» (Zanafilla 1:1).

Një shtëpi nuk është më e qëndrueshme se sa themeli i saj. Se sa të qëndrueshme janë pjesët e ndryshme të një shtëpie, kjo varet nga fortësia e themelit mbi të cilin kjo shtëpi qëndron.

Themeli kryen për shtëpinë të njëjtin funksion që kryen përgjigja që ne i japim pyetjes: «A ekziston Perëndia në të vërtetë?» për jetën tonë. Besimi apo mosbesimi në Perëndi krijon një themel për mënyrën se si ne mendojmë dhe kjo mënyrë të menduari u jep kuptim dhe formë ideve tona për jetën.

Pra, pyetja më e rëndësishme që çdo njeri duhet t'i bëjë vetes është: «A ekziston Perëndia?» Rëndësia e kësaj pyetjeje qëndron në faktin se nga përgjigja që do të japim do të influencohen të gjitha përgjigjet që do të japim për pyetjet e tjera në jetën tonë. Për shembull, le të mendojmë se një njeri i përgjigjet kësaj pyetjeje në këtë mënyrë: «Jo, Perëndia nuk ekziston.» Kështu, kur ky njeri do të ballafaqohet me pyetjen: «Çfarë jete duhet të bëj në këtë botë?», ai ndoshta do të përgjigjet: «Unë mund të jetoj si të dua. Në fund të fundit nuk jam një qenie e krijuar dhe nuk i jap llogari asnjë fuqie më të lartë.» Në rastin më të mirë ky njeri mund të thotë: «Përgjegjësia e vetme që kam është që të kontribuoj sa më shumë për lumturinë dhe mirëqënien e njerëzve. Dhe, sa për jetën time, unë jam “vetë zot dhe vetë shkop” dhe nuk i jap llogari askujt. Meqenëse nuk ka jetë pas vdekjes, mund të bëj në jetë çdo gjë që do të më sjellë kenaqësi.»

Në të kundërt, le të themi se i njëjti njeri i përgjigjet pyetjes: «A ekziston Perëndia në të vërtetë?», duke thënë: «Po, Ai ekziston.» Në këtë rast ky njeri me siguri do t'i japë një përgjigje krejt të ndryshme pyetjes «Çfarë jete duhet të bëj në këtë botë?» Në përgjigje të kësaj pyetjeje, ai mund të thotë: «Unë jam i krijuar nga Perëndia. Perëndia ka një qëllim të qartë për jetën time dhe duhet ta zbuloj atë qëllim. Unë mund të gjej paqen dhe qëllimin e vërtetë të jetës vetëm kur të bëj vullnetin e Perëndisë dhe të jetoj sipas udhëzimeve të Tij. E di se një ditë duhet të jap llogari për mënyrën se si kam jetuar.» Pra, përgjigja që do t'i japim pyetjes «A ekziston Perëndia në të vërtetë?» do të influencojë shumë përgjigjet e gjithë pyetjeve të tjera që mund të kemi për jetën.

Pra, le t'i kushtojmë rëndësinë e duhur kësaj pyetjeje. A ka arsye të forta që na bindin në ekzistencën e Perëndisë?

Bibla, në faqet e para të saj, nuk përpiket të argumentojë ekzistencën e Perëndisë. Në fakt ajo fillon duke e pranuar ekzistencën e Perëndisë: «Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën» (Zanafilla 1:1). Në të gjithë Biblën zbulojmë prova të besueshme për ekzistencën e Perëndisë. Disa nga këto prova jepen drejtpërdrejt dhe disa të tjera jepen tërthorazi, disa shprehen qartë dhe disa të tjera nënkuptohen. Bibla, ndër të tjera, nënvizon dy arsye kryesore ku mund të mbështetet besimi në ekzistencën e Perëndisë. Në qoftë se i kushtoni seriozitetin e duhur shqyrtimit të këtyre dy arsyeve, ato do t'ju inkurajojnë edhe ju të besoni në vërtetësinë e ekzistencës së Perëndisë.

BOTA NË TË CILËN JETOJMË ËSHTË NJË PROVË E EKZISTENCËS SË PERËNDISË

Prova e parë, që na shtyn të besojmë se Perëndia ekziston në të vërtetë, na vjen nga bota përreth nesh dhe nga universi në përgjithësi. Toka dhe universi në mënyrë të dukshme deklarojnë ekzistencën e Perëndisë.

Ne jetojmë në një planet që e quajmë tokë. Toka është pjesë e sistemit diellor. Të gjithë planetet e këtij sistemi rrotullohen rreth diellit. Sistemi diellor funksionon sipas një plani dhe rregulli shumë të saktë. Gjithë planetet qëndrojnë në orbitat e tyre dhe ato kurrë nuk përplasen me njëri-tjetrin. Ato rrotullohen rreth diellit me shpejtësinë e duhur dhe në distancën e duhur. Nga rrotullimi i tokës rreth diellit rezultojnë dita dhe nata si edhe stinët, këtu bazohet edhe kalendari që përdorim. Toka qëndron gjithnjë në distancën e duhur nga dielli. Në qoftë se do të ishim në një distancë pak më të madhe nga dielli, ne do të ngrininim nga të ftohtët (temperaturat në tokë do të ishin shumë të ulëta), në qoftë se toka do të ishte më afër diellit ne do të përcëlloheshim (nga temperaturat shumë të larta që do të rezultonin si rezultat i kësaj afërsie).

Shkencëtarët na tregojnë se në hapësirë ekzistojnë shumë sisteme të tjerë diellorë. Ne madje nuk dimë me siguri as dimensionet e universit. Teleskopët që përdorim nuk janë në gjendje të na tregojnë gjithçka që shtrihet përreth nesh dhe mendjet tona nuk mund ta imagjinojnë gjithë shtrirjen e universit. Edhe pse nuk dimë shumë gjëra rreth universit, dimë me siguri se universi funksionon sipas një plani dhe rregulli. Ai nuk funksionon në kaos ku çdo lëvizje apo proces është i rastësishëm, por funksionon në harmoni dhe çdo lëvizje apo proces është shumë i organizuar.

Ekzistenca e universit na bën që të nxjerrim dy konkluzione për të. Së pari, universi u krijua nga një qenie inteligjente, ose, së dyti, universi u formua aksidentalisht apo rastësisht. Në qoftë se pranoni se universi u formua aksidentalisht, ka vetëm dy mundësi: ai u krijua nga asgjëja apo hiçi, ose krijimi i tij ishte rezultat i ndonjë shpërthimi kozmik në lëndën që ekzistonte para se ky univers të krijohet. Nga sa u tha më lart, është më se e logjikshme se i vetmi konkluzion i arsyeshëm për krijimin e universit është se u krijua nga dikush. Si mund ta pranojmë me ndershmëri se universi u krijua nga asgjëja? Si mund të besojmë duke përdorur arsyen

tonë se universi u krijua nga një shpërthim kozmik dhe se materia është e vetmja gjë që ka ekzistuar gjithnjë?

Supozoni se një njeri me një libër në dorë më afrohet. Ai më jep librin dhe më kërkon ta lexoj. E marr librin dhe filloj ta shfletoj. Në kapakun e librit shkruhet «Fjalori i Gjuhës të Sotme Shqipe». Gjithashtu në kapak lexoj emrin e shtëpisë botuese «Naim Frashëri». Ndërsa shfletoj faqet e librit, vërej se aty janë gjithë fjalët në përdorim të gjuhës shqipe si dhe shumë fjalë që nuk janë të përdorimit të përditshëm. Këto fjalë janë të rreshtuara sipas një rendi alfabetik dhe janë të shoqëruara me shpjegime për kuptimin e tyre. Në kapakun e librit thuhet se mbi 30,000 fjalë gjenden në libër. Padyshim, mund t'i them këtij njeriu se ky është libri më i dobishëm për këdo që dëshiron të studjojë gjuhën shqipe me themel. Gjithashtu mund t'i them atij: «Unë do të kontaktoj me shtëpinë botuese dhe do të përpiqem të blej një kopje të librit.»

Njeriu me të cilin bisedoj thotë: «Ti nuk mund ta blesh kopjen e këtij libri. Ky libër nuk është botuar nga shtëpia botuese «Naim Frashëri» dhe as nuk është shkruar nga autorët, emrat e të cilëve mund të lexohen në faqen e parë të librit. Ky libër u krijua rastësisht. Ky libër u krijua nga asgjëja. Ai as nuk u krijua nga ndonjëri dhe as nuk u shtyp në ndonjë shtypshkronjë. Ne vetëm sa e zbuluam këtë libër ashtu siç është. Ai erdhi nga asgjëja.» Unë do t'i përgjigjem këtij njeriu: «A po më thua se gjithë kjo listë fjalësh me gjithë shpjegimet e kuptimeve të tyre nuk është rezultat i punës të një krijuesi apo grupi krijuesish? A po më thua se këto 30,000 fjalë me shpjegimet e tyre u krijuan nga asgjëja? A po thua se ky libër nuk u faqos, nuk u shtyp dhe nuk u lidh nga dikush?»

Në qoftë se njeriu do të përgjigjej: «Po, kjo është vërtetë», atëherë duhet t'i thosha: «Unë kam një mendje me të cilën mund të arsyetoj. E di se e ke gabim. Të respektoj si qenie njerëzore, por aftësia ime për të arsyetuar nuk do të më lejojë të pranoj përfundimin tënd për orgjinën e këtij libri. Mund ta them me siguri se ky libër nuk u krijua rastësisht.» Unë mund të jem i sigurt për përgjigjen time ndaj këtij njeriu, sepse aftësia ime për të arsyetuar nuk do të më lejonte që të nxirrja ndonjë përfundim tjetër për orgjinën e librit.

Supozoni se një njeri tjetër më afrohet dhe më jep një makinë rroje elektrike dhe më thotë:

«Dëshiroj që ta shikosh këtë makinë rroje. Kordoni mund të lidhë makinën dhe prizën dhe përmes energjisë elektrike makina mund të përdoret për të rruar mjekrën. Brenda makinës ndodhet një vend për të vendosur bateritë. Ndërsa makina është në prizë, një sasi energjie elektrike grumbullohet në bateri për përdorim në të ardhmen. Kështu, mund ta përdorësh makinën edhe kur nuk ke mundësi ta vësh në prizë. Pra, mund ta përdorësh si në shtëpi ashtu edhe kur udhëton. Ajo është një pajisje shumë praktike.» Supozoni se e marr makinën në dorë dhe e shikoj. Makina është e markës «Phillips». Mund t'i them këtij njeriu: «Një pajisje si kjo do të më ndihmojë shumë. Unë udhëtoj shpesh dhe një makinë si kjo do të më hyjë shumë në punë. Do të përpiqem të blej një makinë rroje elektrike si kjo.»

Imagjinoni sikur ky njeri të më thotë: «Oh, jo. Kjo makinë nuk mund të blihet. Ajo nuk u prodhua nga askush. Ajo u krijua rastësisht. Jo larg prej këtej ndodhej një fabrikë në magazinat e të cilës ndodheshin gjithë llojet e materialeve, plastike, metalike, dru, etj. Para pak javësh një shpërthim ndodhi në atë ndërtesë. Këto materiale u shpërndanë në ajër. Ndërsa ishin në ajër, disa nga këto materiale u bashkuan së bashku, u lidhën së bashku dhe ranë për tokë në formën e kësaj pajisjeje. Në mes të rrënojave të ndërtesës së shkatërruar, ne gjetëm këtë makinë rroje. Kjo makinë as nuk u projektua dhe as nuk u prodhua nga ndonjë njeri, ajo u krijua si pasojë e shpërthimit.» Unë do t'i them këtij njeriu: «Po më shtyn që të besoj se kjo makinë nuk u projektua dhe nuk u krijua nga dikush? Po më thua se kjo makinë është rezultat i aksidentit dhe lëvizjes pa drejtim të materialeve në ajër? Beson se kjo makinë u krijua rastësisht dhe jo me paramendim?» Në qoftë se ky njeri akoma do të këmbëngulte se makina erdhi nga shpërthimi, do t'i thosha: «E ke gabim. Mund të jesh një njeri i shkolluar dhe serioz, por këto që po thua nuk janë të drejta. Asnjë njeri me logjikë nuk mund të arrijë në një përfundim të tillë. Nuk mund ta imagjinoj që një makinë rroje mund të krijohet në këtë mënyrë.» Do të isha absolutisht i sigurt në përgjigjen time ndaj këtij njeriu. Aftësia ime për të arsyetuar nuk do të më lejonte të arrija në një përfundim të tillë.

Përfundimi i sigurt që kemi arritur për librin dhe makinën e rrojes është i njëjti përfundim që duhet të nxjerrim, madje edhe me më shumë besim, për universin. Asnjë shpjegim shkencor apo përdorim

termash të ndryshëm nuk mund të na shtyjë që të besojmë se universi u krijua nga asgjëja apo si rezultat i një shpërthimi. Universi, pjesë e të cilit është edhe planeti ynë, toka, është shumë herë më i komplikuar se sa një libër apo një makinë rroje. Në qoftë se nuk mund të besojmë se një libër u krijua rastësisht apo se një makinë rroje u krijua nga një shpërthim, atëherë si mund të besojmë se universi u krijua nga asgjëja apo erdhi nga shpërthimi i lëndës pa jetë? Të gjithë ata që e kanë studiuar universin me sadopak seriozitet kanë arritur në përfundimin se ai funksionon në një mënyrë që është sa komplekse dhe e ndërlikuar, aq edhe e organizuar dhe e rregullt.

Bibla e përforcon këtë rezultat të arritur me anë të logjikës. Te Psalmeve 19:1 thuhet: «Qiejtë tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall veprën e duarve të tij.» Me fjalë të tjera, në qoftë se do të uleshim në tokë gjatë një nate të qartë dhe do të vështronim qiellin me yje, ne do të ishim dëgjuesit e një folësi të mrekullueshëm. Folësi në këtë rast do të jetë qielli i errët me yjet e panumërt në të. Ne do të jemi spektatorët. Vendi i takimit do të jetë bari mbi të cilin ulemi. Folësi do të deklarojë në mënyrë të qetë, por të kuptueshme se yjet nuk erdhën rastësisht, por u krijuan. Qielli me yje do të bëjë të njohur lavdinë e Perëndisë. Pasi të largohemi nga kjo shërbesë nderimi ne nuk do të debatojmë me folësin, por do të themi: «Mesazhi që folësi solli është i drejtë. Arsyeja jonë nuk do na lejonte që të pranojmë ndonjë mesazh të ndryshëm nga ky.»

Abraham Linkoln tha: «Unë mund ta kuptoj se si dikush, që shikon botën ku jetojmë, mund të bëhet ateist, por s'mund të kuptoj se si dikush që shikon qiellin lart nuk beson në Perëndi.» Imanuel Kant, filozofi i shquar gjerman, shkroi: «Dy gjëra më habisin: qielli plot me yje lart dhe ligji moral (*që ekziston*¹) brenda çdo njeriu.»

Pali shkroi: «Në fakt cilësitë e tij të padukshme, fuqia e tij e përjetshme dhe hyjnia e tij, duke qenë të dukshme nëpërmjet veprave të tij që nga krijimi i botës, shihen qartë, me qëllim që ata të jenë të pafalshëm» (Romakëve 1:20). Gjërat e dukshme dhe të qarta të universit vërtetojnë ekzistencën e dorës së padukshme të Perëndisë. Ato na tregojnë rreth fuqisë të Tij të jashtëzakonshme dhe rreth karakterit hyjnor të Tij. Ne mësojmë për ekzistencën e Perëndisë me anë të dëshmisë së përgjithshme, botës rreth nesh dhe botës sipër nesh, universit. Pali gjithashtu tha: «Por nuk e la veten e vet pa dëshmi,

duke bërë mirë, duke na dhënë shira prej qiellit dhe stinë të frytshme dhe duke i mbushur zemrat tona me ushqim dhe gëzim» (Veprat 14:17). Bota në të cilën jetojmë dhe universi në përgjithësi dëshmojnë për ekzistencën e Perëndisë.

Në historinë e famshme, Robinson Kruzoja përfundoi në një ishull të pabanuar. Pasi doli në breg të detit, i shpëtuar për mrekulli nga mbytja e anijes në të cilën ndodhej, menjëherë pa rreth e rrotull për njerëz të tjerë që mund të kishin shpëtuar. Asnjë njeri nuk dukej. Ishte i vetmi që i kishte shpëtuar përmbytjes së anijes. Kërkoi kudo nëpër ishull për njerëz të tjerë, por më kot. Arriti në përfundimin se ishte i vetmi njeri në ishull. Ai ndërtoi një shtëpi me degë e drurë dhe jetoi duke u ushqyer me frutat e egra që rriteshin në ishull. Zinte në kurthe, që i përgatiste vetë, kafshë të egra dhe, pasi i vriste, i përdorte për ushqim dhe veshje. Një ditë duke ecur në breg të detit, pa mbi rërën e imët gjurmët e një njeriu. Menjëherë mendoi se njeriu që kishte lënë ato gjurmë ose ishte larguar nga ishulli, ose ishte ndërkohë në ishull dhe i vdekur, ose ishte akoma gjallë dhe ndodhej në ishull. Kjo e fundit, mendimi se mund të takonte një njeri tjetër në ishull, bëri që zemra e tij të rrahë prej gëzimit. Gjurmët e vërtetonin dyshimin e tij. Ai mund të ishte absolutisht i sigurt për këtë. Kërkoi nëpër të gjithë ishullin dhe, më në fund, gjatë një dite të premtë, ai gjeti njeriun vendas që la gjurmët. Ai e quajti atë «e Premtë», sipas ditës në të cilën e kishte gjetur.

Ne i ngjasojmë personazhit Robinson Kruzo. Ç'do ditë jetojmë në presencën e tokës, të yjeve, të diellit dhe të hënës. Këto janë gjurmë që u lanë nga një Qenie e plotfuqishme. Dhe nuk ka ndonjë dyshim për të. Kruzoja do të kishte qenë i mangët po të arrinte në përfundimin se gjurmët u krijuan rastësisht apo se ato erdhën nga asgjëja. Gjurma e një njeriu në një rrethanë si ajo e Kruzosë nuk mund t'i shpëtojë as edhe një njeriu të pavëmendshëm. Në të njëjtën mënyrë, ne do të ishim naivë nëse nuk do të mendojmë me kthjelltësi rreth gjithë këtyre gjurmëve të krijimit të universit dhe në mënyrë të pandershme të arrinim në përfundimin se toka dhe universi u krijuan rastësisht, se erdhën nga asgjëja, nga hiçi.

Kam lexuar një histori për një misionar², i cili shkoi për të predikuar Biblën në zonë shumë të largët të Afrikës. Ai gjeti një fis të vogël i cili nuk qe vizituar nga ndonjë misionar kurrë më parë. Jetoi

me ta dhe mësoi gjuhën e tyre. Pasi fitoi besimin dhe respektin e tyre, filloi t'u fliste atyre për Perëndinë. Një natë, ndërsa ishin të ulur rreth një zjarri, u tregoi atyre se si Perëndia krijoi tokën, qiejtë dhe njeriun. Një burrë i moshuar po dëgjonte me vëmendje të madhe. Papritur ai kërceu nga gëzimi dhe tha: «Unë e dija se duhet të kishte një Perëndi të tillë, por vetëm se nuk ia dija emrin deri tani.»

Përfundimi i tij është edhe yni gjithashtu. Nuk mund të gjendet një përfundim më i logjikshëm se ky. Bota rreth nesh dhe ajo mbi ne (universi) na udhëheqin vetëm drejt një përfundimi se një Perëndi i plotfuqishëm e ka krijuar këtë tokë dhe gjithçka tjetër që është përtej saj. Ne mund ta besojmë këtë ashtu siç besojmë se një libër s'mund të krijohet rastësisht dhe se një makinë rroje s'mund të vijë nga një shpërthim.

NJERIU VETË ËSHTË PROVË E EKZISTENCËS SË PERËNDISË

E dyta, ne mund të besojmë me siguri se Perëndia ekziston me të vërtetë nga evidenca që na vjen nga ekzistenca e njeriut. Ekzistenca e njeriut bën të njohur ekzistencën e Perëndisë.

Njeriu është një mrekulli akoma më e madhe se sa universi që na rrethon. Mendoni për një moment për aftësitë intelektuale të njeriut. Njeriu mund të arsyetojë, të besojë, të dashurojë, të ëndërrojë, të planifikojë dhe të krijojë. Pak kohë më parë takova shumë të rinj në Ukrainë që flisnin rrjedhshëm tre apo katër gjuhë të huaja. Shkencëtarët na tregojnë se një qelizë e vetme në trurin e njeriut është shumë herë më komplekse edhe se kompjuteri më i fuqishëm.

Mendoni për anën shpirtërore të njeriut. Njeriu gjithnjë ka qenë një krijesë që ka nderuar Perëndinë. Edhe fiset njerëzore më primitive shikojnë lart për të nderuar ndonjë krijesë më të fuqishme. Njeriu brenda vetes ka një sens të detyrimit moral. Njeriu ka një ndërgjegje morale brenda tij. Disa herë kjo ndërgjegje nuk është shumë e drejtë, por ajo gjithmonë është e pranishme. Njerëzit primitivë besojnë se brenda fisit të tyre është e gabuar të vrasësh, të vjedhësh apo të jesh imoral.

Mendoni për trupin fizik të njeriut. Mund të kaloni tërë jetën duke studjuar ndonjë pjesë të trupit të njeriut dhe prapë nuk do të arrini ta njihni atë plotësisht.

Mendoni për vetë jetën. Njeriu nuk mund ta krijojë jetën dhe as mund ta rikthejë atë (të ringjallë një kufomë). Ne nuk mund ta studiojmë dhe nuk mund ta kontrollojmë jetën njerëzore plotësisht. Një krijesë e mrekullueshme si njeriu bën të njohur ekzistencën e Krijuesit të tij, Perëndisë.

Le të supozojmë se jemi në një klasë dhe po dëgjojmë një profesor të shquar që flet për origjinën e jetës. Në thelb, duke lënë mënjanë terminologjinë shkencore dhe shpjegimet, ai thotë: «Që në fillimet e hershme një qelizë e vogël e një lloji të caktuar ekzistonte dhe ajo kishte një lloj jete në të. Kjo qelizë u rrit, u shumëfishua dhe u zhvillua. Një lloj krijese që jetonte në det u krijua. Kjo krijesë u rrit, u shumëfishua dhe u zhvillua. Një lloj krijese tokësore u krijua. Kjo krijesë u rrit, u shumëfishua, dhe u zhvillua. Më në fund, me kalimin e miliona viteve, nga ky proces një krijesë që quhet njeri erdhi në këtë botë.»

Ndërsa dëgjojmë profesorin ballafaqohemi me tre probleme të cilat teoria e tij nuk arrin t'i shpjegojë. Profesori nuk i përmend këto probleme sikur ato të ishin të parëndësishme dhe të pavlefshme për t'u përmendur, por tek ato varet vetë besueshmëria e teorisë së tij. Anashkalimi i këtyre problemeve bën që teoria e tij të jetë e papranueshme. Problemi i parë është origjina e jetës. Teoria e tij presupozon se jeta erdhi nga asgjëja. Çdo qenie njerëzore me logjikë do ta ketë të pamundur të besojë se një libër mund të vijë nga asgjëja dhe se një makinë rroje mund të formohet nga një shpërthim. Nga ana tjetër jeta është shumë herë më komplekse se sa një libër apo një makinë rroje. Njeriu mund ta krijojë një libër apo një makinë rroje, por s'mund të krijojë jetën. Megjithatë profesori kërkon që ne të besojmë se jeta erdhi nga asgjëja.

Problemi i dytë është shpjegimi i ekzistencës së ligjeve të natyrës. Teoria e profesorit presupozon se ligjet e natyrës erdhën nga asgjëja. Universi në të cilin jetojmë drejtohet nga ligje të sakta të natyrës. Në qoftë se nuk ha ushqim, do të vdesësh. Nuk mund ta shpërfillësh apo ta anashkalosh këtë ligj. Asnjë njeri nuk përjashtohet nga veprimi i këtij ligji. Në qoftë se nuk fle, trupi yt do të rrëzohet nga lodhja. Nuk mund të dalësh përmbi këtë ligj të natyrës. Dhe as nuk mund ta evitosh ligjin natyror të vdekjes. Pavarësisht se gjejmë një kurë për sëmundjen e zemrës, ne do të vdesim një ditë nga pleqëria. Përqindja e njerëzve që vdesin është 100

për qind. Dhe nuk ka përjashtime. Profesori, me teorinë e tij, kërkon të «provtojë» se ligjet e natyrës u krijuan rastësisht.

Problemi i tretë është shpjegimi për ekzistencën e familjes. Shoqëria njerëzore përbëhet nga njësi të cilat i quajmë familje. Familja ka qenë e rëndësishme për njeriun gjatë gjithë historisë të tij. Nuk mund të gjejmë ndonjë periudhë në historinë njerëzore në të cilën familja nuk ka ekzistuar. Profesori dëshiron që ne të besojmë se mashkulli kaloi nëpërmjet një procesi zhvillimi derisa u bind se martesë ishte e domosdoshme për të. Ai do të na thotë se femra kaloi nëpërmjet një procesi të ngjashëm dhe arriti në konkluzionin se martesë ishte e domosdoshme për të në të njëjtin moment që mashkulli arriti në të njëjtin konkluzion. Kështu, ata rastësisht zbuluan gëzimin e të jetuarit së bashku dhe kështu, që nga ajo kohë, burri dhe gruaja kanë vazhduar të bashkohen për të krijuar familje. Burri është i ndryshëm nga gruaja dhe gruaja është e ndryshme nga burri, megjithatë ata janë bërë që të jetojnë dhe të merren vesh njëri me tjetrin. Profesori thotë se ata u poqën në të njëjtën kohë dhe krijuan familje. Me fjalë të tjera, ai pretendon se familja erdhi nga asgjëja dhe se u krijua fare rastësisht.

Mendjet tona nuk do të lejojnë që të besojmë se jeta erdhi nga asgjëja dhe se ligjet e natyrës u krijuan rastësisht dhe se familja njerëzore u formua nga asgjëja. E vetmja mënyrë e arsyeshme që mund të shpjegojë ekzistencën e njeriut vjen nga fakti se një Qenie më e lartë e krijojë atë dhe e vendosi mbi këtë tokë për një arsye të veçantë.

Atë që ne kemi nxjerrë si përfundim përmes arsyes, Bibla e shpall me qartësi. Kapitulli i parë i Biblës shpjegon: «Pastaj Perëndia tha: “Ta bëjmë njeriun sipas shembëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe”» (Zanafilla 1:26). Sipas Biblës, jeta njerëzore erdhi prej jetës hyjnore. Akoma më tej, na tregohet: «Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shembëlltyrës së vet, sipas shembëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin dhe femrën. Dhe Perëndia i bekoj; dhe Perëndia u tha atyre: “Të jeni të frytshëm dhe shumëzohuni, mbushni tokën e nënshtrojeni, e sundoni mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit dhe mbi çdo qenie që lëviz mbi tokë”» (Zanafilla 1:27–28). Perëndia u dha qenieve njerëzore shpirt

dhe i bëri të ngjashëm me veten e Tij. Ai krijoi familjen, duke i bërë njerëzit me dy sekse të ndryshëm: mashkull dhe femër. Perëndia krijoi ligjet e natyrës që drejtojnë edhe jetën njerëzore në tërësinë e saj.

Arsyeja na shtyn që të pranojmë se jeta njerëzore u krijua nga dora e të Plotfuqishmit dhe se Perëndia e kishte një qëllim kur e krijoi njeriun. Pa hezitim, ne mund të bashkohemi me thënien e Davidit: «Po, ti ke formuar të përbrendëshmet e mia, ti më ke endur në barkun e nënës sime. Unë do të të kremtoj, sepse jam krijuar në mënyrë të mrekullueshme, veprat e tua janë të mrekullueshme dhe unë e di shumë mirë këtë gjë» (Psalmeve 139:13–14).

Prej disa vitesh ne kemi krijuar një traditë që një misionar të gjendet gjithmonë në universitetin tonë (Harding University, Searcy, AR, USA). Për këtë përzgjidhet çdo vit një misionar të cilit i kërkohet që së bashku me familjen e tij të punojnë për universitetin për një vit të tërë. Qëllimi i kësaj është që studentët të dëgjojnë nga goja e një misionari për jetën dhe punën e tij. Disa vite më parë ne ftuam në universitetin tonë Howard Horton, i cili ka shërbyer si misionar në shumë vende të botës. Kur ai erdhi në një nga klasat në të cilat unë jepja mësim për t'u treguar studentëve rreth punës misionare, më pëlqeu një nga idetë që ai prezantoi. Ai tha: «Kam qenë në vende të ndryshme të botës dhe përveç ndryshimeve kam parë edhe gjëra që nuk ndryshojnë kur kaloj nga një vend në tjetrin. Për shembull, kur i mësoj fëmijët e vegjël në vende të ndryshme se dy plus dy jep katër, ata gjithmonë e pranojnë këtë si të vërtetë. Ata, në mendjet e tyre, verifikojnë nëse çfarë po u them është e vërtetë dhe arrijnë në përfundimin e drejtë se ajo është e vërtetë. Mendjet e tyre të vogla e analizojnë atë që u them dhe konkludojnë se është e vërtetë. Në të njëjtën mënyrë, kur u mësoj njerëzve, në këto vende të ndryshme, se Perëndia krijoi tokën, universin dhe njeriun, ata mendojnë për të dhe më pas arrijnë në përfundimin se ky koncept është i vërtetë. Diçka në mendjet e tyre e thith këtë mësim dhe e pranon si të vërtetë. I kam parë njerëzit të reagojnë në këtë mënyrë në çdo vend që kam qenë.»

Në qoftë se do të mendoni për ekzistencën e njeriut, jetën e tij, inteligjencën e tij, natyrën e tij shpirtërore, ndërgjegjen e tij, moralin sipas të cilit

jeton dhe trupin e tij fizik, natyrisht do të arrini në përfundimin se ai nuk u krijua rastësisht, por u krijua nga një Qenie e plotfuqishme. Mund të kini besim të plotë se Perëndia ekziston në të vërtetë. Ekzistenca e njeriut është një provë e ekzistencës të Perëndisë.

KONKLuzioni

Mendoni serozisht për dy provat e studiara më lart. Shikoni me vëmendje se si krijimi i botës dhe i njeriut provojnë ekzistencën e Perëndisë. Ky përfundim është kaq i logjikshëm dhe i pamohueshëm sa Bibla thotë: «I pamendi ka thënë në zemër të tij: “Nuk ka Perëndi”» (Psalmeve 14:1).

Gjithashtu është e arsyeshme të besosh se kjo Qenie e plotfuqishme që na ka krijuar do të na gjykojë një ditë të gjithëve. Ai do na kërkojë llogari për mënyrën se si kemi jetuar. Kjo është pikërisht arsyeja që Perëndia dërgoi Jezusin në botë dhe na dha Biblën. Ai donte që ne ta kuptojmë arsyen pse jemi në këtë botë dhe çfarë duhet të bëjmë ndërsa jetojmë jetën që vetë Perëndia na dha. Jezusi tha: «Kush më hedh poshtë dhe nuk i pranon fjalët e mia, ka kush e gjykon; fjala që kam shpallur do të jetë ajo që do ta gjykojë në ditën e fundit» (Gjoni 12:48).

E vërteta më e mrekullueshme që Jezusi dhe Bibla na shpalosin është se Perëndia i cili na krijoi dëshiron që të na adoptojë si fëmijët e Tij. A e imagjinoni dot këtë? Ai që krijoi diellin, hënën, yjet, tokën dhe gjithë universin kërkon që unë të bëhem pjesë e familjes të Tij të përjetshme! Ai më ka ftuar në familjen e Tij me anë të ungjillit të Birit të Tij. Unë adoptohem në familjen shpirtërore të Perëndisë kur i bindem ungjillit përmes besimit te Jezusi, kur pendohem për mëkatet e mia, kur e pranoj besimin në Jezusin para njerëzve të tjerë dhe kur pagëzohem (Efesianëve 1:5; Galatasve 4:6).

Sipas Biblës, mund të zbuloni, jo vetëm se Perëndia ekziston në të vërtetë, por, gjithashtu, se mund të bëheni me të vërtetë fëmijë të Tij!

SHËNIME

¹ Shënim i përkthyesit.

² Çdo kristian që ia dedikon jetën e tij, ose një pjesë të saj, shpërndarjes së Fjalës të Zotit, Biblës, zakonisht midis njerëzve që s'janë bashkëkombësit e tij. Kjo zakonisht kërkon prej tyre të lënë vendin e tyre dhe të shkojnë në vende të tjerë.